"27 Nëntori", "7 Shtatori", "Abaz Shehu", "Abaz Thaçi", "Abdyl Henci", "Adem Dehari", "Adem Gashi", "Adem Isufi" (Te Vneshtat), "Adem Selmani", "Afërdita", "Afrim Abazi", "Agim Osaj", "Agim Selmanaj", "Agim Zeneli", "Agron Ramaj", "Agron Mehmetaj", "Ahmet Kaçiu", "Ahmet Shtimja", "Ahmet Zeneli", "Albert Rama", "Aleks Buda", "Aleksander Mojsiu", "Ali Pashë Gucia", "Alush Hoti", "Anamali", "Aqif Blyta", "Ardhmëria", "Arif Dautaj", "Arta" (Kodra e Trimave), "Asllan Berisha", "Asllan Pireva", "Avni Rrustemi", "Azem Babiqi", "Azem Behluli", "Azem Bejta", "Avni Dudi", "Bahtir Dumnica", "Bahtir Sheholli", "Bahtjar Morina", "Bajram Gogaj", "Bajram Krasniqi", "Bajram Latifi", "Balshajt", "Bardhok Biba", "Bataljoni Atlantiku", "Bedri Ahmeti", "Bedri Bislimi", "Bedri Dedja", "Bedri Sokoli", "Bejtush Gërbeshi", "Bekim Lushaku", "Bekim Mani", "Beqë Lokaj", "Beqir Musliu", "Beqir Sadiku", "Berid Beker", "Berlini", "Besim Levonja", "Besnik Lajçi", "Besnik Maroca", "Blerim Ademi", "Bubulina", "Butrinti", "Çamëria", "Çeçile Krasniqi", "Çeta e Llapit", "Dalip Alshiqi", "Dasho Shkreli", "Demë Ahmeti", "Demë Ali Pozhari", "Dervish Cara", "Dervish Shaqa", "Dhurata Xoxa", "Dil Mramori", "Dom Ndoc Likaj", "Drita Pelingu", "Elfir Behrami", "Emin Sinanin", "Enver Olluri", "Ernes Zariqi", "Eva Brendli", "Fadil Sejdiu", "Faik Rama", "Faik Ukëhaxha", "Fan Noli", "Fahrie Hoti", "Fatmir Gjata", "Favzi Rama", "Fieri", "Fitim Duraku", "Florim Rushiti", "Fushë-Kruja", "Gani Balaj", "Gërmia", "Gëzim Dershvishaj", "Gjallica", "Gjamil Fluku", "Gjeravica", "Gjon Loku", "Gollaku", "Gostivari", "Habib Zeka", "Hafëz Ali Korça", "Haki Pavataj", "Hakif Rimanishta", "Halim Gjelo", "Hamit Pacolli", "Haraçina", "Hasan Dema", "Hasan Ferri", "Hasan Prishtina", "Hasan

Remniku", "Hazir Hagjolli", "Hilmi Zariqi", "Hisen Arifi", "Hydajet Lezha", "Hysen Peleniku", "Ibrahim Fehmiu", "Ibrahim Jakova", "Ibrahim Kelmendi", "Ibrahim Temo", "Ibri", "Idriz Gashi", "Idriz Shahmani", "Igballe Prishtina", "Ilir Soba", "Ilmi Bahtiri", "Indrit Cara", "Isa Demaj", "Islam Rekaliu", "Ismail Gorani", "Ismail Ismaili", "Ismet Asllani", "Ismet Gucia", "Ismet Jashari", "Ismet Mustafa", "Istria", "Isuf Berisha", "Izet Shatri", "Jakup Ferri", "Jani Vreto", "Jashar Erevara", "Jeronim De Rada", "Jetë Hasani", "Jetullah Osmani", "Jetullah Kastrati", "Kadri Minushi", "Kadri Qerimi", "Kajo Karafili", "Kalosh Dani", "Karadaku", "Kastrioti", "Ker Sadria", "Kolë Idromeno", "Kolë Parubi", "Kolonja", "Kongresi i Elbasanit", "Kongresi i Lushnjës", "Kongresi i Manastirit", "Kopliku", "Korça", "Koto Hoxhi", "Kristo Floqi", "Kuka", "Kuvendi i Bujanit", "Labeatet", "Zllatar", "Leka i Madh", "Leskoviku", "Lezha", "Liliana Çavolli", "Lirie Jashari", "Luçie Bashota", "Lugëmiri", "Lulzim Morina", "Luma", "Lutfi Vitia", "Malush Miriqi", "Mamurasi", "Manastiri", "Marie Shllaku", "Martaneshi", "Masar Begolli", "Masar Kodra", "Matej Serreqi", "Mbreti Longar", "Mehdi Kosumi", "Mehë Uka", "Milihate Ajeti", "Memo Mato", "Miftar Zejnallahu", "Mihail Grameno", "Mihailo Pupin", "Mikel Marubi", "Milaim Qerimi", "Minatori", "Mirsad Abduli", "Mirsad Gashi", "Morea", "Muhamet Sokoli", "Muharrem Adili", "Mujdin Alia", "Mukadeze Lika", "Mustafa Krantja", "Myrtë Zeneli", "Naim Gashi", "Namik Delvina", "Naser Hajrizi", "Nazmi Ismaili", "Nazmi Pacolli", "Nazmi Zhegrova", "Ndoc Nikaj", "Ndre Mjeda", "Nebil Duraku", "Nerodimja", "Nexhmedin Zajmi", "Nexhmi Llumnica", "Niketë Dardani", "Nikolla Naço", "Nikollë Ivanaj", "Onufro", "Orikumi", "Oso Kuka", "Osumi", "Panajot Kanaçi", "Përmeti", "Peshteri", "Petro Makro", "Pietro Marubi", "Plava", "Pojani", "Prespa", "Preveza", "Qazim Plhana", "Qemal Stafa", "Qëndresa", "Rafet Isufi", "Ragip Ademi", "Ramadan Çitaku", "Ramë Bllaca", "Ramë Govori", "Ramë Lajqi", "Ramë Vllasa", "Ramiz Varvarica", "Rasim Kiçina", "Remzi Demolli", "Reshat Muqa", "Reshat Shehu", "Rexhai Surroi", "Rexhep Rexhepi", "Rifat Frashëri", "Risto Siliqi", "Rrahman Dini", "Rrasa e Zogut", "Ruhan Pacolli", "Sabit Rrahimi", "Sabri Godo", "Sadete Mekuli", "Sadik Shala", "Sadri Kullevi", "Safete Juka", "Sahit Najdeti", "Salajdin Braha", "Sali Butka", "Sali Mani", "Salih Gjuka", "Sazani", "Sefedin Fetiu", "Sejdi Sejdu", "Sejfullah Malëshova", "Selim Tahiri", "Selim Veselaj", "Shaban Avdiu", "Shabi Gërbeshi", "Shahin Gashi", "Shahin Krasniqi", "Shala e Bajgorës", "Shasi", "Shefki Desivoica", "Shefki Kuleta", "Sheh Myhedini", "Shejnaze Juka", "Shën Naumi", "Shëngjini", "Sheshi i Arbërit", "Shkëlzen Haradinaj", "Shkodra", "Shkreli", "Shuko Dalipi", "Skënder Anamali", "Skënder Luarasi", "Skënder Matallari", "Skifter Arifi", "Skrapari", "Sokrati", "Spiro Dine", "Sterio Spasse", "Tafil Boletini", "Tahir Jaha", "Tahir Sinani", "Tajar Hatipi", "Tomori", "Toplica", "Ujëmani", "Ukë Mavriqi", "Uljini", "Vahit Mustafa", "Vedat Kokona", "Viena", "Viktor Hygo", "Visar Dodani", "Xheladin Deda", "Xheladin Kurtaj", "Xhelal Preveza", "Xhemë Bardhoshi", "Xhemë Elezi", "Xhevët Begolli", "Xhevët Berisha", "Zahir Haxholli", "Zarife Jashari", "Zef Skiroi", "Zejnullah Halili", "Zekeria Rexha", "Zeqir Halili", "Zhan Dak", "Zhan Zhak Ruso", "Ziaver Vllasaliu", "Zihni Sako", "Zukë Haxhia", fshatrat: Bardhoshi, Nëntë Jugoviqi, Llukari, Shkabaj, Orlloviqi dhe Zllatari.

Zona e nëntë

Zona e nëntë përfshinë këto rrugë: "Azem Sopi", "Kavaja", "Kryestogu", "Sherif Dedinca", fshatrat: Barileva, Prugoci, Drenoci, Mramori, Busia, Besia, Slivova, Radasheci, Sharbani, Makoci, Ballabani, Prapashtica, Glllogovica, Teneshdolli, Lebana, Truda, dhe Vranidolli.

Zona e dhjetë

Zona e dhjetë përfshinë këto fshatra: Shashkoci, Novosella, Grashtica, Keqekolla, Mareci, Dragoci, Nisheci, Siçeva, Koliqi, Dabisheci, Hajkobilla, Rimanishta dhe Kukaj.

Sqarim:

- Çagllavica, Hajvalia, Sofalia, Kolovica e Vjeter dhe Matçani, zonohen sipas emërrimit të rrugëve.
 - Çdo emër i rrugës që nuk figuron në këtë rregullore, do t'i takojë zonës më të përafërt të rrugës sipas lokacionit.

Vlera e pronave përcaktohet sipas zonave të vlerësimit dhe janë shprehur në € për 1 m², si vijon:

Zonat:

Zona e parë:

Zona e dytë:

Fushë sportive 140

Zona e tretë:

Zona e katërt:

Zona e pestë:

Zona e gjashtë:

Pronë bujqësore.....	70
Garazh	100
Pronë e papërfunduar	188
Fushë sportive	100

Zona e shtatë:

Pronë me destinim banimi dhe rezidencial:	banesë	300
	shtëpi	330
Pronë komerciale		520
Pronë industriale		490
Pronë bujqësore		60
Garazh		80
Pronë e papërfunduar		132
Fushë sportive		90

Zona e tetë:

Zona e nëntë:

Zona e dhjetë:

Vlera e pronave bujqësore dhe të braktisura, do të caktohet në bazë të analizave të bëra për pronat përkatëse, me normën përkatëse prej 0.15 %.

Neni 6
Lirimi nga tatimi në pronën e paluajtshme

6.1 Institucionet dhe organizatat e cekura më poshtë, do të lirohen nga tatimi për pronën që e posedojnë ose e shfrytëzojnë:

- a) Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- b) UNMIK - u, KFOR - i, ICO -ja dhe EULEX -i;
- c) Përfaqësítë diplomatike dhe konzullatat e akredituara në shtetin e Kosovës, rregullimi i të cilave bëhet me marrëveshje të reciprocitetit mes shteteve, zyrat e huaja të ndërlidhjes, agjencitë qeveritare, organizatat ndërqeveritare ose agjencitë e huaja donatore që ofrojnë ndihmë humanitare, punë rindërtimi, administrim civil ose ndihmë teknike brenda Kosovës;
- d) Organizatat joqeveritare me status të përfitimit të ndërsjellë publik, në përputhje me Ligjin për asocimin e organizatave joqeveritare në Kosovë;
- e) Institucionet fetare të përcaktuara me ligj, prona e të cilave mbahet dhe shfrytëzohet vetëm për qëllime fetare dhe
- f) Objektet të cilat me ligj janë shpallur monumente të mbrojtura kulturore e historike.

6.2 Lirimi nga tatimi në pronën e paluajtshme, i përcaktuar në nenin 6.1, nuk vlen për pronarët e pronës së paluajtshme, përvèç pronave të saktësuara në nenin 6.1.

6.3. Lirimi nga tatimi, sipas nenit 6.1, nuk vlen kur:

- a) prona shfrytëzohet ose mbahet për shfrytëzimin e veprimtarisë komerciale dhe për krijimin e të ardhurave, ose
- b) prona e zotëruar ose e shfrytëzuar nga një organizatë joqeveritare me status të përfitimit publik, nuk shfrytëzohet ekskluzivisht për qëllime të përfitimit publik.

Neni 7
Lirimi nga tatimi në pronën e paluajtshme për kategoritë e veçanta

7.1. Lirimi nga tatimi në pronën e paluajtshme për familjet e dëshmorëve, familjet e të zhdukurve të UÇK-së, invalidët e UÇK-së, invalidët civilë të luftës, familjet e viktimate civile të luftës që janë në gjendje të rëndë ekonomike, do të bëhet konform dispozitave të nenit 6 të Ligjit r. 04/L-054, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtorisë Çlirimtare të Kosovës, viktimate civile dhe familjeve të tyre.

7.2. Lirimi nga tatimi në pronën e paluajtshme për të verbërit, do të bëhet konform dispozitave të nenit 6 të Ligjit nr. 04/L - 092, për personat e verbër.

7.3. Kryetari i Komunës do të caktojë një komision që do t'i shqyrtojë kërkesat për lirim nga tatimi në pronë për kategoritë e cekura në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Zbritja lidhur me vendbanimin kryesor

Personit fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendlod se prona ose njësia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej 10.000 € nga vlera e tatushme e pronës.

Neni 9

Regjistrimi dhe informacioni për pronën

9.1 Të gjithë personat të cilët kanë ose banojnë në një pronë të paluajtshme, janë të obliguar që ta regjistrojnë atë pronë në bazë të dhënavë për tatimin komunal të pronës, dhe t'i ofrojnë Komunës informacionin lidhur me pronën e paluajtshme, e cila i nënshtronhet regjistrimit më 1 mars ose para 1 marsit të çdo periudhe tatimore.

9.2 Të gjithë personat, të cilët kanë, shfrytëzojnë ose marrin një pronë të paluajtshme, përveç rasteve të caktuara në nenin 9.3, duhet t'i lejojnë zyrtarët e autorizuar që përfaqësojnë autoritetet komunale të tatimit, të hyjnë në tokën dhe në ndërtesat e tyre gjatë orëve të ditës për t'i mbledhur të dhënat lidhur me vlerën e pronës.

9.3 Komuna mund të kërkojë nga UNMIK-u, KFOR-i, ICO-ja, EULEX-i ose zyrat e jashtme të ndërlidhjes që posedojnë ose shfrytëzojnë pronë të paluajtshme, të sigurojnë të dhëna mbi atë pronë për bazën e të dhënavë tatimore mbi pronën komunale. Sigurimi i një informacioni të tillë duhet të bëhet në baza vullnetare dhe nuk cenon privilegjet dhe imunitetin që mund të vlejë në këto raste.

Neni 10

Organi kompetent komunal për vjeljen e tatimit

Organi kompetent komunal per vjeljen e tatimit në pronë është Drejtoria e Financave.

Neni 11

Informacioni lidhur me tatimin në pronë

11.1 Drejtoria duhet të themelojë dhe të mbajë një bazë të dhënash lidhur me tatimin në pronë, por pa u kufizuar vetëm në tatimin në pronë, duke përfshirë adresat e pronës, adresat e poseduesve dhe të shfrytëzuesve të pronës, të dhënat mbi tokën dhe ndërtesat, vlerat e pronës, faturat e pronës dhe shënimet mbi pagesat e tatimit.

11.2 Baza e të dhënavë për pronën duhet të mbështetet në regjistrin e të drejtave mbi pronën dhe kadastrën e tokës. Organi përgjegjës për punët e kadastrit do të sigurojë bazën e të dhënavë për tatimin në pronë dhe informacionin e nevojshëm nga regjistri mbi të drejtën në pronën e paluajtshme. Organi duhet të sigurojë për Agjencinë Kadastrale të Kosovës të dhënat nga baza e të dhënavë mbi pronën, në intervale kohore që do të caktohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

11.3 Informacioni mbi regjistrimet e pronës në bazë të të dhënavë përkitazi me tatimin në pronën e paluajtshme, duhet të jetë në dispozicion të publikut.

Neni 12 **Vlerësimi i pronës**

12.1 Ministria e Financave nxjerrë udhëzim administrativ, me të cilin parashtrohen standardet unike të vlerësimit, sipas të cilave Komuna e vendos vlerën e pronës në treg. Standardet përfshijnë variablet relevante të vlerësimit, siç janë vlera në pajtim me kontratën e shitjes së pronës së paluajtshme, e vlerësuar nga organi kompetent, të ardhurat të cilat krijojen nga prona, shpenzimet e ndërtimit, vendi, madhësia dhe gjendja e pronës. Standardet do të bazohen në një vlerësim të përgjithshëm, pos rasteve kur prona shfrytëzohet për qëllime të veçanta ose për pronë unike.

12.2 Drejtoria e përcakton vlerën e tregut të pronës që është nën juridikcionin e saj, në pajtim me standardet e përcaktuara në përputhje me dispozitat e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

12.3 Drejtoria e shqyrton dhe e përcjell vlerën e tregut të çdo prone që është nën juridikcionin e saj, për çdo tri ose pesë vjet.

12.4 Drejtoria e rivlerëson pronën çdo vjet, nëse janë kryer ndërtime të reja ose janë bërë përmirësime thelbësore në pronë dhe nëse ekziston ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e pronës.

12.5 Pronari ose shfrytëzuesi i pronës mund të kërkojë nga Komuna rivlerësimin e pronës, kur prona ka pësuar dëm, për të cilin nuk është shkaktar ose përgjegjës pronari apo shfrytëzuesi, siç janë dëmet që mund të ndodhin nga thatësira, vërvimi, zjarri, tërmeti, lufta ose fatkeqësitë e tjera.

Neni 13 **Faturat e tatimit**

13.1 Varësisht nga kushtet e parashtruara në këtë rregullore, Drejtoria do të autorizohet për të lëshuar fatura të tatimit vjetor të pronës.

13.2 Lëshimi i faturave të tatimit të pronës bëhet para 31 marsit të secilit vit.

13.3 Fatura e tatimit në pronë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- a) Identifikuesin e bazës së të dhënavë për tatimin në pronë;
- b) Emrin e tatimpaguesit;

- c) Adresën e pronës;
- d) Adresën për dërgimin e faturës së tatimit, nëse është e ndryshme nga adresa e pronës;
- e) Vlerën e vlerësuar të pronës;
- f) Tarifën e tatimit;
- g) Detyrimin total të tatimit;
- h) Datën kur duhet të bëhet pagesa e tatimit;
- i) Procedurën për pagesën e faturës së tatimit dhe
- j) Shqyrtimin dhe të drejtën për t'u ankuar, së bashku me procedurat e nevojshme.

Neni 14

Pagimi i tatimit

14.1 Për vitin tatimor dhe vitet vijuese, tatimi i caktuar me anë të kësaj rregulloreje duhet të paguhet në dy këste të barabarta, më 30 qershor dhe më 31 dhjetor të vitit tatimor ose përparrë.

14.2 Pagesa e tatimit në pronë duhet të bëhet në tërsi nëse kërkohet të bëhet transfer i pronës apo ndërrim i pronarit, qoftë ai tatimpagues i ligjshëm, shfrytëzues i ligjshëm apo shfrytëzues tjeter sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje.

14.3 Pagesa e tatimit në pronë për ish-ndërmarrjet shoqërore që janë privatizuar, duhet të bëhet sipas llogaritjeve, në përputhshmëri me rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme, duke përfshirë këtu edhe llogaritjen e dënimit dhë kamatës sipas neneve 19 dhe 20 të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Shtyrja e tatimit

15.1 Drejtoria në rrithana të veçanta, të cilat do të shkaktonin vështirësi të tepruara për tatimpaguesin, mund t'i lejojë tatimpaguesit që ta shtyjë pagimin e tatimit, me kusht që shtyrja të vlefjet për një faturë të caktuar të tatimit, e cila kufizohet për një afat kohor që nuk i tejkalon dy vjet. Tatimpaguesit të cilët kërkojnë lehtësim sipas këtij nenit, duhet të paraqesin dëshmi thelbësore që mbështesin kërkjesat e tyre për vështirësitë e tyre të paligjshme.

15.2 Procedurat për shtyrjen e tatimit, duke përfshirë edhe natyrën e dëshmisë që duhet të paraqitet për këtë qëllim, duhet të përcaktohen me anë të një udhëzimi administrativ, i cili duhet të jetë në harmoni me Udhëzimin e nxjerrë nga Ministria e Financave.

Neni 16 **E drejta e pengmarrjes për tatim**

16.1 Sipas kësaj rregulloreje, çdo mospagim i tatimit të pronës përbën të drejtën e pengmarrjes në dobi të Komunës.

16.2 Nëse Komuna e regjistrion të drejtën e pengut në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme, një e drejtë e tillë e pengut do të ketë përparësi mbi të gjitha të drejtat e tjera të pengmarrjes të dorëzuara më vonë. E drejta e pengut përfundon pas pagesës së plotë të borxhit të tatimit.

16.3 Personi, pasuria e të cilit i nënshtrohet të drejtës së pengut, mund të ankohet në Komunë për t'u liruar nga e drejta e pengut, në rast se poohet se është bërë gabim me rastin e parashtrimit të kërkesës për të drejtën e pengut.

Neni 17 **Vjelja e detyruar e tatimit**

17.1 Drejtoria duhet të emërojë tatimvjelësit për të zbatuar vjeljen e tatimit në pronë.

17.2 Nëse tatimpaguesi nuk e kryen pagesën e duhur, tatimvjelësit mund të lëshojnë vërejtjen e fundit me shkrim, me anë të së cilës shprehet qëllimi për të konfiskuar pronën personale që i takon personit të tillë. Vërejtja e tillë duhet:

- a) t'i dërgohet tatimpaguesit (dhe do të konsiderohet e vlefshme madje edhe në rastet kur tatimpaguesi refuzon për të pranuar dokumentin);
- b) të shpallet në vendbanimin apo lokalet e punës së tatimpaguesit, ose
- c) të dërgohet me postë në adresën e fundit të ditur të tatimpaguesit.

17.3 Nëse tatimpaguesi nuk e paguan shumën e plotë të tatimit të papaguar me dënimet dhe kamatat brenda 10 ditësh pas dorëzimit të vërejtjes përfundimtare për tatimpaguesin, do të jenë të ligjshme për tatimvjelësit që:

- a) t'ia lëshojnë njoftimin mbi konfiskimin personit i cili ka detyrim t'i paguajë tatimpaguesit pagë, qira ose borxh tjetër;
- b) t'ia dorëzojë bankës njoftimin për konfiskim ose palës tjetër të tretë lidhur me pasurinë e tatimpaguesit që është në posedimin e tij;
- c) t'i përfundojë shërbimet komunale lidhur me pronën e tatimpaguesit dhe
- d) të konfiskojë dhe të shesë pronën personale të tatimpaguesit.

17.4 Nga konfiskimi lirohen: ndihmat për fëmijë dhe ndihmat sociale, veshmbathja themelore, ushqimi themelor, orendidë themelore, gjërat themelore personale (duke përjashtuar gjërat luksoze), mjetet e punës së tatimpaguesit.

Neni 18
Humbja e së drejtës në pronë

18.1 Nëse edhe pas dy vjetësh nga njoftimi përfundimtar i pagesës së tatimit borxhi i tatimpaguesit nuk është paguar, atëherë Drejtoria mund t'ua dërgojë një njoftim për konfiskimin e pronës së paluajtshme të gjithë personave që janë të interesuar për atë pronë.

18.2 Nëse pagesa nuk bëhet brenda 30 ditësh nga data kur njoftimi mbi konfiskimin e pronës i është dërguar tatimpaguesit, Komuna mund ta shesë pronën, ose një pjesë të pronës, në një ankand publik, në pajtim me rregullat dhe procedurat që do të përcaktohen me një udhëzim administrativ të lëshuar nga Ministria e Financave.

18.3 Tatimpaguesi i cili nuk e ka paguar tatimin dhe nuk është pronar i pronës që i nënshtrohet procedurës së konfiskimit, mund të mos e fitoje të drejtën e pronësisë mbi këtë pronë përmes ankandit publik. E njëta vlen për bashkëshortin e tatimpaguesit dhe vartësit e tij që kanë lidhje farefisnie të shkallës së parë.

18.4 Pas përfundimit të shitjes, në pajtim me nenin 18.2, dhe pasi ofertuesi më i lartë të ketë paguar shumën e plotë të ofertës:

- pagesa duhet të depozitohet në një llogari të besuar pengmbajtëse,
- gjykata e lëshon urdhrin, me të cilin i jepet e drejta e pronësisë ofertuesit më të lartë pas gjashtë muajve të lëshimit të urdhrit. Vendimi i tillë hyn në fuqi menjëherë, përveç nëse e drejta e riblerjes, sipas nenit 18.4 (c), është ushtruar me sukses, me ç 'rast pagesa e bërë për atë shitje nga ofertuesi më i lartë do të kompensohet pa vonesë dhe
- tatimpaguesi, i cili nuk e ka paguar tatimin, e ka të drejtën absolute të shlyerjes së detyrimit mbi pronën e paluajtshme përkatëse për një periudhë gjashtëmuore pas pagesës së të gjitha borxheve të papaguara të tatimit. E drejta e shlyerjes do të kufizohet vetëm për pronarin ose tatimpaguesin i cili nuk e ka kryer pagesën. Kjo e drejtë e shlyerjes së detyrimit të tatimpaguesit ka të bëjë vetëm me tatimpaguesin i cili nuk e ka bërë pagesën. Ushtrimi i së drejtës së shlyerjes së pagesës së tatimpaguesit, nuk i jep atij kurrfarë të drejtash sa i përket pronës plotësuese që ka ekzistuar para konfiskimit.

18.5 Prona e shitur në ankand publik, sipas kësaj rregulloreje, do të jetë e lirë dhe e pastruar nga detyrimet tatimore pronësore të përparshme, madje edhe nëse Komuna nuk e merr shumën e plotë të tatimit të papaguar për shkak të ankandit publik.

18.6 Prona e nevojshme për banim, siç është përcaktuar në nenin 5.2 (a), nuk mund të shitet në ankand publik apo në ndonjë formë tjetër të konfiskuar pa dashje.

Neni 19 Dënimet

19.1 Secilit tatimpagues i cili nuk bën kërkesë për regjistrim të pronës së paluajtshme, ose nuk i siguron Komunës informacionin për tatimin në pronë, në pajtim me nenin 9.1, do t'i dërgohet një vërejtje përfundimtare. Nëse ai nuk i përbahet brenda 60 ditësh pas dërgimit të njofitimit, atëherë atij do t'i merret e drejta për të ushtruar ankesë lidhur me tatimin.

19.2 Secili person i cili refuzon të drejtën për inspektim, në pajtim me nenin 9.2, lejon inspektimin në afat prej 60 ditësh nga refuzimi i parë, ose e humb të drejtën për të ushtruar ankesë kundër tatimit.

19.3 Secilit tatimpagues që nuk e paguan tatimin në pronë në datën ose para datës së përcaktuar për pagesë, i shtrohet dënnimi në një shumë të hollash që është e barabartë me 5% të obligimit tatimor.

19.4 Secili tatimpagues i cili nuk e paguan tatimin në pronë brenda 60 ditësh pas ditës së fundit të përcaktuar për pagesë, do t'i nënshtrohet një dënnimi plotësues në një shumë të hollash që është e barabartë deri në 10% të obligimit tatimor.

Neni 20 Kamata

Kamata do të llogaritet në baza mujore nga data kur duhet të paguhet tatimi deri në datën kur paguhet tatimi.

Neni 21 Ankesat administrative lidhur me faturat e tatimit në pronën e paluajtshme

21.1 Tatimpaguesi i cili ankohet se vlera e vlerësuar e pronës nuk ka qenë vlerë e tregut, se ekzistojnë gabime në bazën e të dhënave tatimore mbi pronën, sipas të cilave fatura e tatimit është bazuar ose se fatura e tatimit është e padrejtë, mund të kërkojë shqyrtimin e faturës së tatimit nga Bordi komunal për ankesat lidhur me tatimin mbi pronën e paluajtshme, brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i faturës së tatimit.

21.2 Tatimpaguesi i cili nuk pajtohet me vendimin e lëshuar nga Bordi komunal, mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të vendimit nga Bordi komunal në Divisionin Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat.

21.3 Në procedurën e ankesave, për çështje që nuk janë paraparë në këtë rregullore gjen zbatim Ligji për administratën tatimore në fuqi.

Neni 22

Autorizimi për lëshimin e faturave të tatimit në pronën e paluajtshme

22.1 Drejtoria duhet të ketë autorizimin valid për lëshimin e faturave të tatimit nga Ministria e Financave, me qëllim të lëshimit të faturave të tatimit dhe vjetes së tatimit në pronë në përputhje me këtë rregullore.

22.2 Për të marrë autorizimin e tillë, Komuna duhet të dëshmojë para Ministrisë së Financave, se ajo:

- a) i ka identifikuar dhe regjistruar karakteristikat fizike të pronës së tatushme me pronën e cila lirohet nga tatimi,
- b) ka themeluar një bazë të dhënave tatimore mbi pronën,
- c) ka zbatuar kriteret e vlerësimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 12 të kësaj rregulloreje,
- d) ka caktuar tarifat tatimore mbi pronën në pajtim me këtë rregullore dhe
- e) ka treguar aftësinë administrative për të kryer menaxhimin e informimit mbi pronën, vlerësimin e pronës, faturimin, vjetjen, vjetjen e dhunshme dhe ankesat administrative.

22.3 Ministria e Financave do t'u bëjë inspektime vjetore komunave të cilat kanë marrë autorizime. Inspektimi i tillë duhet të garantojë se janë duke u zbatuar standarde parapara të vlerësimit, se baza e të dhënave tatimore mbi pronën mirëmbahet në mënyrën e duhur, se procedurat e vjetes së dhunshme zbatohen në mënyrë adekuate dhe se Komuna vepron në përputhje me këtë rregullore.

22.4 Nëse inspektimi i kryer në pajtim me nenin 21.5 vërteton se Komuna nuk i është përbajtur materialisht kësaj rregulloreje, Ministria e Financave duhet t'i bëjë vërejtje asaj komune ku konstatohet natyra e mospërputhjes, si dhe veprimi i kërkuar për respektimin e kësaj rregulloreje.

22.5 Ministria e Financave mund t'i anulojë autorizimin e lëshuar secilës komunë, e cila nuk ndërmerr veprimet e duhura lidhur me respektimin e kësaj rregulloreje, brenda 90 ditësh nga pranimi i vërejtjes së tillë.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Shfuqizimi

23.1. Me fillimin e zbatimit të kësaj rregulloreje, pushon të vlefje Rregullorja për tatim në pronën e paluajtshme, 01 nr. 110 - 223380, dt. 02.10.2015.

22.2. Kjo rregullore do të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit 2017.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 110 - 246609, më 03.10.2016

